

VENDIM
Nr.854, datë 17.12.2004

**PËR KRITERET DHE MASËN E PËRFITIMIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË PËR
BASHKËSHORTIN/EN E USHTARAKUT AKTIV TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 37 e 48 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkëshortit/es së ushtarakut aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) të Forcave të Armatosura t’i jepet pagë papunësie, sipas kriterëve dhe në masën e përcaktuar në këtë vendim, kur ushtaraku emërohet në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm, brenda apo jashtë vendit, si dhe kur plotëson këto kriterë:

a) Ndërron vendbanim së bashku me familjen, të vërtetuar me certifikatën familjare, për rastet e emërimit brenda vendit, a të vërtetuar nga struktura ku shërben, për rastet e emërimit jashtë vendit.

b) Bashkëshorti/ja humbet vendin e punës;

c) Në vendbanimin e ri nuk ka mundësi punësimi;

ç) Nuk ushtron veprimtari fitimprurëse;

d) Nuk trajtohet me ndihmë ekonomike.

2. Paga e papunësisë jepet në emër të bashkëshortit/es së papunë në qendrën e punës së ushtarakut.

3. Masa e pagesës të jetë:

a) 100 për qind e pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune mbi 1 deri në 10 vjet.

b) 120 për qind e pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune mbi 10 vjet.

Pagesa e papunësisë ndryshon sa herë ndryshon pagesa minimale në shkallë vendi.

4. Bashkëshorti/ja e ushtarakut, për të përfutur pagesën e papunësisë, duhet të paraqesë kërkesën për punë në zyrat e punës dhe të përkrahjes sociale dhe në institucionin ku shërben bashkëshorti ushtarak.

5. Në rast refuzimi pa arsye të vendit të punës së ofruar nga institucionet e përmendura në pikën 4 të këtij vendimi, sipas profesionit dhe specialitetit, përfituesit i ndërpritet pagesa e papunësisë.

6. Pagesa e papunësisë mund të përfitohet për një periudhë deri në 7 vjet.

7. Bashkëshorti/ja e ushtarakut, që ka përfutur sipas shkronjës “b” të pikës 3 të vendimit nr.86, datë 12.3.1992 të Këshillit të Ministrave “Për disa të drejta e detyrime të ushtarakëve, të cilat rrjedhin nga ligji nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, do të vazhdojë të përfitojë pagesë papunësie, në masën e përfutur në mbështetje të vendimit nr.86, datë 12.3.1992, edhe për 7 vjet, por jo më shumë se 15 vjet dhe jo më të vogël se masa e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.

8. Bashkëshorti/ja e ushtarakut, që ka përfutur pagesën e papunësisë e përfiton atë edhe pasi ushtaraku nxirret në rezervë, në lirim ose vdes, por jo më shumë se periudha e caktuar në pikën 6 të këtij vendimi dhe në përputhje me kriteret e vendosura në këtë vendim. Në çdo rast, paga e papunësisë do të tërhiqet në strukturën ku është trajtuar financiarisht ushtaraku.

9. Pagesa e papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut, që shërben jashtë strukturës organike të Forcave të Armatosura, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Periudha e trajtimit me pagesë papunësie sipas këtij vendimi njihet si vjetërsi sigurimi, për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, në përputhje me ligjin “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

11. Kontributi për këtë periudhë të derdhet në emër të bashkëshortit/es përfituese, të llogaritur mbi masën konkrete të kontributit minimal, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, dhe të përballohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe përfituesi.

Masa e kontributit për pension pasqyrohet në listëpagesat tip, të miratuara nga Instituti i

Sigurimeve Shoqërore.

12. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

13. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

14. Shkronja “b” e pikës 3 të vendimit nr.86, datë 12.3.1992 të Këshillit të Ministrave “Për disa të drejta e detyrime të ushtarakëve, të cilat rrjedhin nga ligji nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 14.5.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano